



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kuvendi

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, me 25.09.2018

Dokument parlamentar

R A P O R T

PËR ZGJEDHJEN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË INSTITUTIT PËR STUDIMET E KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT NË SHQIPËRI

I-Hyrje:

Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në mbledhjen e datës 25.09.2018, në zbatim të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, zhvilloi seanca dëgjimore, si dhe vlerësoi kriteret ligjore dhe të meritës të kandidatëve të propozuar nga Konferenca e Rektorëve për një vend vakant për anëtarë të Bordit të ISKK.

II - Baza Ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të ISKK:

Ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”

Nenet 8, 18, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, përcaktojnë mënyrën e zgjedhjes, subjektet që propozojnë anëtarët e Bordit të ISKK, si dhe kriteret ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të ISKK.

Neni 8

Bordi i institutit

1. Bordi i institutit (më tej “bordi”) është organi më i lartë drejtues. Ai përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët emërohen dhe lirohen nga Kuvendi, në bazë të një liste kandidatësh të propozuar nga:

- a) Instituti i Integritetit të ish të Përndjekurve Politikë (3 anëtarë);**
- b) shoqëria civile (1 anëtar);**
- c) Akademia e Shkencave (1 anëtar);**
- ç) Konferenca e Rektorëve (2 anëtarë).**

Për çdo vend për anëtar bordi propozohen 3 kandidatë.

2. Anëtarët e bordit duhet të jenë personalitete të njohura nga komuniteti akademik dhe shoqëria civile, të cilët zotërojnë aftësi profesionale dhe kanë dhënë kontribut, që krijojnë bindje se mund të mbështesin institutin në realizimin e misionit e të detyrave të tij. **Anëtarët e**

bordit duhet të plotësojnë të gjitha kushtet, që parashikojnë aktet ligjore dhe nënligjore për nëpunësit e lartë të shërbimit civil, si dhe kushtet e përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji.

3. Anëtarët e bordit zgjidhen për 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

4. Mandati i anëtarit të bordit është i papajtueshëm me funksione të larta shtetërore, kushtetuese, politike, administrative, si dhe me anëtarësinë në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Mandati i anëtarit të bordit është, gjithashtu, i papajtueshëm edhe me anëtarësinë në parti dhe lëvizje politike.

Neni 18

Kriteret e veçanta

1. Nëpunësit dhe punonjësit e institutit e të arkivit duhet të jenë persona që gëzojnë besueshmëri. Për qëllimet e këtij ligji, i besueshëm është çdo person, i cili ka mbushur moshën madhore përpara datës 8 dhjetor 1990 dhe nuk ka qenë:

a) **anëtar ose kandidat i PKSH-së a PPSH-së;**

b) **i shkolluar ose nuk ka bërë kualifikime në shkollat e larta politike të sigurimit ose mbrojtjes të Shqipërisë a të vendeve të Traktatit të Varshavës;**

c) funksionar i sistemit komunist, pjesëtar i organeve të diktaturës komuniste apo bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit;

ç) anëtar ose bashkëpunëtor i shërbimeve inteligjente të vendeve të Traktatit të Varshavës.

2. Plotësimi i kërkesave, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni verifikohet përmes dokumenteve të lëshuara nga organet/institucionet që parashikon ligji.

III- Propozime të Konferencës së Rektorëve:

Konferenca e Rektorëve, në zbatim të nenit 8, pika 1, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, ka depozituar në Kuvend kandidaturat tre (3) kandidatura alternative për një (1) vend vakante për anëtarë të Bordit të ISKK, si më poshtë vijon:

1- z.Alfred LAKO

2- z.Peter SARAÇI

3- z.Bajram Gjishti

Jetëshkrimi i kandidaturave të propozuara nga Konferenca e Rektorëve për anëtarë të Bordit të ISKK:

1- z.Alfred LAKO

Arsimimi: Diplomë Universitare Inxhinier Mjedisi, 1994 – 1997, “Universitetin Poitiers – ESIP, Francë”; Diplomë Universitare “Inxhinier Hidroteknik” 1990 – 1999, “Universiteti Politeknik Tiranë”, Fakultetin i Inxhinierisë së Ndërtimit; 2010 - 2014, Doktoraturë në “Impiantet e Trajtimit të Ujit”, Universiteti Politeknik Tiranë, Fakultetin i Inxhinierisë së Ndërtimi.

Eksperienca profesionale: Ka eksperiencë 20 vjeçare në mësimdhënie si letor në Universitetin Politeknik të Tiranës. Nga vitit 2010 deri në vitin 2018, ka qenë anëtar i Bordit të Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri.

2- z.Peter SARAÇI

Arsimimi: Është diplomuar në vitin 2005, në “Universitetin e Padovës Itali”, Fakulteti Ekonomisë, Dega Ekonomi e Tregëti - Bankë dhe Financë; në vitin 2008 ka kryer studimet Master në Financë – Bankare në Universitetin e Padovës Itali, Fakulteti Ekonomisë;

Eksperianca profesionale: Shtator - Dhjetor 2008, Specialist Buxheti pranë Kuvendit të Shqipërisë; që nga viti 2008 dhe vazhdim është pedagog në “Universitetin e Shkodrës Luigj Gurakuqi”, Fakulteti Ekonomisë, është lektor në lëndët: Teknikë Bankare, Paraja dhe Banka, Menaxhim Bankar. Ka disa publikime shkencore në fushën e ekonomisë. Nuk ka depozituar vërtetim të gjëndjes gjyqësore.

IV - Vlerësimi i kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidaturave për anëtarë të Bordit të ISKK, të propozuara nga Konferenca e Rectorëve:

1- z.Alfred LAKO - plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenet Nenet 8, 18, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, si dhe nuk ka kushte papajtushmërie ligjore me nenin 8, pika 4 të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

2- z.Peter SARAÇI - plotëson kriteret ligjore të përcaktuara në nenet Nenet 8, 18, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri, si dhe nuk ka kushte papajtushmërie ligjore me nenin 8, pika 4 të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri.

3- z.Bajram Gjishiti, nuk ka depozituar asnjë dokument shoqërues dhe nuk është paraqitur në seancën dëgjimore të datës 25.09.2018.

V- Përfundime të Raportit:

1- Komisioni për Çështjet Ligjore Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pas zhvillimit të seancave dëgjimore, si dhe pas vlerësimit të kushteve, kriterëve ligjore dhe meritës së çdo kandidati, për anëtarë të Bordit të ISKK, në mbledhjen e datës 25.09.2018, në zbatim të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit;

Vendosi:

2 - Për (1) një vend vakant për anëtarë të Bordit të ISKK, propozim i “Konferencës së Rectorëve”, t’i propozojë seancës plenare për votim kandidaturat e mëposhtme:

- 1. z.Alfred LAKO**
- 2. z. Peter SARAÇI**

KRYETARI

Ulsi MANJA

RELATORE

Klotilda BUSHKA

